



REPUBLIKAE SHQIPËRISË

**BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2907 prot.

Himarë, më 07.04 2025

VENDIM

Nr. 20 , Datë 07.04 2025

PËR

**“DHËNIEN E MIRATIMIT NË PARIM PËR VAZHDIMIN E PROCEDURAVE
LIGJORE PËR KALIMIN E PRONËS “ISH SHKOLLA 8 - VJEÇARE, VUNO” NË
ADMINISTRIM TË MINISTRISË SË EKONOMISË, KULTURËS DHE
INOVACIONIT”**

Bazuar në ligjin Nr.139/2015, datë 19.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjin Nr.44/2025 “Kodi i procedurave administrative”, në mbështetje të ligjit nr.27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, VKM-së nr.101 datë 20/02/2003 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Himarë”, VKM-së nr.362 datë 05/06/2003 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi të Bashkisë Himarë” si dhe referuar vendimit nr.122 datë 21/02/2025 të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale dhe kërkesës së Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë: Këshilli Bashkiak Himarë në mbledhjen e datës 02.04.2025 pasi shqyrtoi materialin e sjell nga Kryetari Bashkisë e miratoi me (18) tetëmbëdhjetë vota pro , (2) dy kundër , (0) zero abstenim dhe si më poshtë vijon,

VENDOSI:

1. Të shprehë dakortësinë për vazhdimin e procedurave ligjore për kalimin e pronës “Ish Shkolla 8 Vjeçare Vuno” në administrim të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, në funksion të ngritjes së muzeut kushtuar historisë së Arbëreshëve.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata dhe Kryetari i Bashkisë Himarë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike, bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 55 pika 6.

KRYETARI
Dhimitër Kapaj

